



5 mars 2018

**Dita ndërkombëtare e Efiçencës së Energjisë: 10 masa të menjëhershme që
Kosova duhet t'i ndërmarrë për rritjen e efiçencës së energjisë**

Hyrje

Në ditën ndërkombëtare të Eficiencës së Energjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës më tepër se në mënyrë deklarative, duhet ta shënoj këtë ditë duke ndërmarrë masa që rrisin eficiencën në sektorë të ndryshëm të shoqërisë. Prioritizimi i eficiencës së energjisë siguron uljen e kostove financiare, mjedisore dhe shëndetësore dhe rritë kualitetin e jetës së qytetarëve të Kosovës. Kjo mund të arrihet duke kombinuar masa dhe politika që kanë në cak eficiencën në ndërtesa, pajisje, transport, industri etj.

Deri më tani, eficienta është parë vetëm si një target që duhet plotësuar; si një obligim ndërkombëtar që duhet plotësuar si pjesë e të qenit palë e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë. Më pak kemi parë përpjekje që eficienta e energjisë të shihet jo thjeshtë si numër dhe target por si një nga burimet e energjisë që mund të llogaritet edhe në projeksionet e energjisë për të ardhmen. Në gjithë këto vite, Kosova ka humbur shumë potencial për eficientë në sektorë të ndryshëm. Megjithatë, ende mund të ndërmerren hapa të shumtë për tëvënë në jetë benefitet financiare, mjedisore dhe të rritjes së kualitetit të jetës përmes eficiencës së energjisë.

Ja dhjetë prej masave që ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e eficiencës së energjisë dhe që Qeveria e Kosovës duhet t'i konsiderojë menjëherë:

1. Krijimi i Ekofondit

Vit pas viti, Qeveria e Kosovës shpallë krijimin e Fondit të Eficiencës ose Ekofondit si prioritet të saj! Përkundër kësaj, së paku që nga viti 2012, Fondi mbetet vetëm prioritet në letër dhe ende nuk është bërë asgjë në realizimin e tij. Shumë shpesh Qeveria është arsyetuar se krijimi i fondeve jashtëbuxhetore nuk lejohet me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë por kjo nuk u pengoi të krijonin Fondin për Veriun dhe Fondin për Garancitë Kreditore! Krijimi i Ekofondit ndikon drejtpërdrejtë në krijimin e mekanizmave nxitës për eficiencën e energjisë. Këta mekanizma do të përfshijnë financimin e projekteve të izolimit të shtëpive, të furnizimit me pajisje eficiente, financim të programeve të riciklimit, të konservimit të energjisë etj.

2. Kodi i Ndërtimit

Kosova duhet të harmonizoj legjislacionin e ndërtimit në atë mënyrë që aplikimi për leje ndërtimore përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim të harmonizohet me Ligjin Nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa. Kodi i Unifikuar i Ndërtimit do të përfshinte edhe rregulloret për eficientë, për ngrohje dhe ftohje, për ventilim dhe klimatizim, për mbrojtje termike dhe kursim të energjisë termike etj. Këto dispozita ligjore duhet të harmonizohen brenda një pakoje ligjore në formën e një Kodi të Ndërtimit ku do të harmonizoheshin kërkesat për materiale ndërtimore me performancën energjetike të objekteve, planifikimin hapësinor të ndërtesave në qytete dhe kërkesat për llogaritjen e performancës së integruar energjetike të ndërtesave.

3. Eko-voztje për më shumë eficiencë në transport

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të krijojë kushte dhe politika për rritjen e eficiencës në transport. Reforma e transportit publik duhet të përfshijë rritjen e kualitetit të shërbimeve dhe promovimin e transportit publik dhe në të njëjtën kohë dekurajimin e përdorimit të veturave me djegie të brendshme. Kosova nevojitet të promovoj përdorimin e automjeteve hibride dhe elektrike dhe të përgatitet për transformimin e sistemit të transportit. Një program kombëtar për eko-voztjen duhet të hartohet në mënyrë që të ketë promovim të voztjes eficiente. Masat duhet të përfshijnë optimizimin e veturave dhe për matjen e performancës së tyre në kohë reale. Koncepti i eko-voztjes duhet patjetër të futet në legjislacionin e rregullave të komunikacionit rrugor dhe të veturave.

4. Qytete të mençura me politika të mençura

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të promovojë konceptin e qyteteve të mençura dhe të ofrojë incentiva për komunat që ndërmarrin masa të eficiencës. Nevojitet zhvillimi i një sistemi të menaxhimit energjetik në komuna i tillë që do t'u mundësoj atyre të kenë sensorë informues në lidhje me performancën energjetike të objekteve, transportit, industrisë dhe objekteve rezidenciale brenda komunës. Këto të dhëna pastaj do të përdoren nga komunat për të orientuar investimet dhe për të bërë planifikimin urban në atë mënyrë që do të optimizojë përdorimin e energjisë! Koncepti i qyteteve të mençura dhe promovimi i sistemeve të menaxhimit të shpenzimit të energjisë dhe të përpunimit të të dhënave nga sistemet komunale të energjisë do t'i mundësoj komunave dhe Qeverisë planifikim më të mirë në fushën e energjisë.

5. Eficiencë në prokurim publik

Qeveria duhet të siguroj se shpenzimi i parasë publike po bëhet duke pasur parasysh adresimin e eficiencës së energjisë nga perspektiva e prokurimit publik. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nuk parashikon eficiencën e energjisë si një nga kriteret në procesin e prokurimit publik. Eficienca në prokurimin publik nënkupton gjithashtu prioritizimin e materialeve eficientë në fushën e energjisë, ndërtimin dhe renovimin e objekteve të reja publike vetëm me materiale eficientë dhe sisteme të monitorimit të shpenzimit të energjisë. Kosova duhet të obligoj të gjitha njësitë institucionale të harmonizojnë katalogët për prokurimin publik në atë mënyrë që të përfshijnë masat për eficiencë të energjisë.

6. Ndrichim publik eficient dhe të mençur

Në rritjen e eficiencës së energjisë ndikim të madh ka ndryshimi i formës së ndriçimit publik. Në Kosovë duhet të merret vendim që asnjë qytet, fshat, lagje, shkollë apo objekt publik të mos ndriçohet nga poça joeficient. Përveç kësaj, duhen inkurajuar përdorimi i poçave eficientë të mençur, të atillë që përdorin sensorë për të detektuar se kur duhen ndezur dhe kur jo! Sisteme komunale të menaxhimit të ndriçimit publik po ashtu duhen inkurajuar në mënyrë që të ketë kontroll të shpenzimit, mirëmbajtje efikase dhe planifikim më të madh të investimeve!

7. Statistika të sektorit

Kosovës ende i mungon një sistem i integruar i statistikave të fushës së energjisë. Kjo përfshinë statistika të shpenzimit të energjisë për të gjitha sektorët, pra një shkallëzim të konsumit final për të gjithë sektorët në kohë reale. Përveç kësaj, nevojiten statistika për nënsektorë dhe një disagregim të plotë të të dhënave. Gjithashtu, në kohë reale duhen procesuar të dhëna mbi intensitetin energjetik tek përdoruesit e fundit për të gjitha sektorët dhe burimet e energjisë. Vetëm me një sistem efikas të statistikave mund të matet suksesi dhe të projektohen politika për të ardhmen në fushën e eficiencës.

8. Politika fiskale për pajisje

Në Kosovë ende poçat joeficientë kanë çmime më të lira sesa ato eficientë. Në të njëjtën kohë, pajisjet joeficiente gjenden me çmime shumë më të lira sesa ato që kursejnë energjinë. Qeveria menjëherë duhet të paraqesë një shkallëzim të akcizave doganore bazuar në performancën energjetike të pajisjeve dhe të inkurajojë qytetarët dhe bizneset të përdorin pajisje eficientë. Në të njëjtën kohë, duhet të ketë një kampanjë vetëdijesimi për përparësitë e përdorimit të pajisjeve eficientë dhe duhet të filloj me materiale promovuese për të gjitha nivelet e shkollave në vend.

9. Politika për ndërmarrjet biznesore

Nevojitet investim në eficiencën e energjisë tek bizneset. Shumica dërrmuese e bizneseve nuk investojnë dhe nuk kanë mjete të investojnë në programe të auditimit energjetik. Këto programe do të duhej t'i ofronte falas Qeveria e Kosovës. Në të njëjtën kohë, bizneset do të asistoheshin në gjetjen e financimit për intervenimet që nevojiten të bëhen. Me programe të veçanta do të përpiloheshin analizat kost-benefit për bizneset dhe do t'u ofrohej këshillim dhe asistencë në realizimin e investimeve. Kjo do të mundësonte një skanim të të gjithë sektorit dhe monitorim më të mirë të gjendjes dhe progresit. Investimi në eficiencë të energjisë do të thotë më shumë fitim për bizneset dhe do të thotë ulje e kostove të operimit në terma afatmesëm dhe afatgjatë!

10. Programe edukimi dhe trajnimi për eficiencën

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të zhvilloj programe të trajnimit të punonjësve për të punuar me materiale eficientë. Kurrikulat e universiteteve publike duhet të përfshijnë më shumë programe të studimeve në fushat që përfshijnë menaxhimin e sistemeve energjetike, eficiencën e energjisë në prodhim dhe konsum si dhe të përfshijë eficiencën e energjisë si lëndë obligative në kurrikulat e programeve inxhinierike, të politikave publike, ndërtimtarisë dhe arkitekturës dhe të fushës së menaxhmentit. Gjithashtu, kurrikulat e qendrave të aftësimi profesional duhet të përfshijnë eficiencën e energjisë në programet e konstruksioneve dhe aftësimi të ndërtimtarëve për punën me materiale eficientë. Duhet t'u jepet përparësi programeve të aftësimi për instalim të mbulesave të shtëpive, izolim të dyshemeve, dritareve dhe çatave dhe të instalimit të pajisjeve eficientë të ngrohjes.